



Nr. i Protokollit 04-03/1009/2

Data 07-06-2023

Kryeshefi Ekzekutiv i Ndërmarrjes Publike Banesore, SH.A. në Prishtinë, në bazë të dispozitave të nenit 26, paragrafi 26.5, të Statutit të Ndërmarrjes Publike Banesore SH.A., nr. 01-592/1, dt. 29.03.2023, në bazë të nenit 6, paragrafi 5, pika 5.1, të Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017 dhe sipas nenit 10.7 të Rregullorës së Brendshme për Procedurat e Rekrutimit, marrëdhënien kontraktuale dhe Avansim në detyrë në Ndërmarrjen Publike Banesore me nr. 01-499/2 datë 01.04.2021 Kryeshefi Ekzekutiv merr këtë:

VENDIM

- I. ANULOHET Konkursi i Publikuar me datë 19.05.2023 për pozitën Kryepunëtor i grupit të pastrimit 1 pozitë në Ndërmarrjen Publike Banesore.
- II. Bazuar në Udhëzimin Administrativ nr.07/2017, i datës 19.10.2017, shpallja e radhës për këtë pozitë do të bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- III. Obligohet Divizioni i Burimeve Njerëzore për zbatimin e këtij vendimi.

Arsyetim

Ndërmarrja Publike Banesore SH.A. Prishtinë ka shpallur konkurs me datë 19.05.2023 për pozitën Kryepunëtor i grupit të pastrimit, bazuar në nenin 6, paragrafi 5, pika 5.1, anulimi i konkursit bëhet nëse së paku 3 kandidatë nuk i plotësojnë kushtet e parapara me konkurs të Udhëzimit Administrativ nr. 07/2017, Kryeshefi Ekzekutiv vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

T'i dorëzohet :

- Kabinetit të Kryeshefit,
- Divizionit të Burimeve Njerëzore,
- Arkivës

Arton Berisha
Kryeshef Ekzekutiv

